



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas
Zyra e Kryetarit
Nr. 031-11020
Drenas, me 27.12.2010



Në vështrim të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit dhe Konkluzionit të Bordit të Drejtorëve të marrur në mbledhjen e datës 24.12.2010, Kryetari i Komunës mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet bordi për shqyrtimin e ankesave të tatimit në pronë, me këtë përbërje:

1. Halim Vrellaku–Kryetar i Komisionit
2. Xhafer Rama -Anëtar
3. Xhavit Nebihi -Anëtar.

II. Bordi është i obliguar në përbërje të plotë të shqyrton ankesat e personave juridik dhe fizikë të ushtruar kundër vendimeve të shkallës së parë të Drejtoratit për Buxhet dhe Financa –Zyra për Tatim në Pronë të Komunës dhe pas shqyrtimit të këtyre ankesave në vështrim të Ligjit dhe Rregulloreve të Komunës që e rregullojnë këtë materie t'i aprovojnë si të bazuara ankesat apo t'i refuzojnë si të pabazuara duke i vërtetuar Vendimet e shkallës së parë të nxjerrur në procedurë administrative.

III. Me këtë vendim do të njoftohen Drejtoratet e Komunës, anëtarët e Komisionit dhe një mbetet për evidencë.



Kryetari i Komunës

Nexhat Demaku
Nexhat Demaku